



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:160980
Datë: 25.10.2024
Numri i dokumentit: 06352690

2024:165493

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit B.B me vendbanim në rrugën “.....”, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga nei 185 paragrafi 2 të KPRK-së dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.Nr.637/24 PP/II.nr.716/24, të datës 10.06.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurit B.B dhe mbrojtësit së tij të caktuar sipas detyrës zyrtare, Av.Samir Reka, të dëmtuarës L.S dhe Përfaqësueses së Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 27.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.10.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.B, i lindur me datën në Ferizaj, nga i ati A....., e ëma I....., e gjinisë D....., me vendbanim në rrugën “.....”, komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I

Me datë 01.05.2024, rreth orës 15:00, në rrugën “.....”, Ferizaj, saktësisht në kafiterinë “.....”, i pandehuri ka dëmtuar pasurinë e personit tjetër-të dëmtuarës L.S, në atë mënyrë që derisa i pandehuri dhe e dëmtuara ishin duke pirë pije alkoolike, i njëjti i'a merr të dëmtuarës telefonin e tipit “Samsung”, ngjyrë të zezë dhe i'a thyen, me ç'rast i shkakton dëm material në vlerë prej 60 €,-

-me këtë veprim ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452, të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1 (një) viti, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale.

E dëmtuara L.S me vendbanim në rrugën “.....”, Komuna Ferizaj, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Konform neni 452 paragrafi 4 i KPPRK-së, i pandehuri B.B lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve procedurale pasi që i njëjti ka gjendje shumë të rënduar ekonomike dhe këtë e dëshmon përmes kartës së ndihmës sociale me numër

Konform neni 362 paragrafi 1, pika 1.1, të KPPK-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse:

Me datën 23.04.2024, rreth orës 18:00, në rrugën “.....”, në Ferizaj, i pandehuri me dashje i ka shkaktuar lëndim trupor të dëmtuarës L.S, më të cilën bashkëjeton, për shkak të një

mosmarrëveshje të vazhdueshme mes vete, në atë mënyrë që pasi kishin shkuar në shtëpinë e të pandehurit, i njëjti fillimisht e sulmon fizikisht të dëmtuarën duke e goditur me shuplaka në fytyrë, pastaj e futë brenda në banjo dhe e lëshon ujin e ngrohtë mbi trupin e saj dhe përsëri e godet me një mjet të rrezikshëm-shufër të gomës në këmbë dhe kraharor, e si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarës i ka shkaktuar **Lëndime të lehta trupore** me dëmtime të përkohshme për shëndetin, të cilat paraqesin skuqje ne këmbë dhe ne duar, gjakëmbledhje nenlekurore ne regjionin e krahëve dhe ne regjionin e kofshës se djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të konstatuara nga eksperti mjeko ligjor Dr....., në akt ekspertimin e datës 27.05.2024,-

-më të cilat veprime do të kryente veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 Kodit Penal të Republikës së Kosovës

- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në shqyrtimin gjyqësor
- Shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP/II.Nr.637/24 PP/II.nr.716/24, të datës 10.06.2024, e ka ngarkuar të pandehurin B.B me vendbanim në rrugën rrugën “.....”, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 të KPRK-së dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.09.2024, ndërsa me datë 27.09.2024 mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, i pandehuri B.B dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare, Av.Samir Reka, Përfaqësuesja e zyrës për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe e dëmtuara L.S.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar

Në shqyrtimin fillestar të datës 18.09.2024 pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 paragrafi 1, të KPPK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit.

Pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri B.B., me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e pranon fajësinë për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së dhe deklaron se këtë veprë e ka kryer në një gjendje nervoze pasi që dikush i panjohur e ka ftuar në telefon të dëmtuarën dhe ai ka dyshuar në të, kurse sa i përket veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, është deklaruar i pafajshëm.

Pas pranimit të fajësisë për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së nga ana e të pandehurit, Gjyqtaria e vetme gjykuese në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit të jap mendimin e tyre lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase ky pranim i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242, të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, prandaj gjykatës i propozon që këtë pranim fajësie të e aprovoj.

E dëmtuara L.S., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale Asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së ka deklaruar se është e vërtetë se B..... ditën kritike ja ka thyer telefonin pasi që ka dëgjuar se dikush e ka ftuar në telefon dhe i ka thënë “ku je oj zemër”, dhe i njëjti menjëherë është nervozuar dhe ja ka thyer telefonin, por të nesërmen ja ka blerë një telefon të ri.

Sa i përket lëndimeve që i ka marrë atë ditë, deklaroi se nuk është e vërtetë që i ka marrë nga B....., atë ditë që ka dhënë deklaratë ka qenë e alkoolizuar deri në maksimum dhe as këmbët nuk e kanë mbajtur, thjeshtë të gjitha çka ka deklaruar kanë qenë të gjitha ëndrra, sajime dhe të gjitha këto veprime i ka bërë për shkak të alkoolit. Shton se B..... ka qenë personi i cili e ka ndihmuar në çdo gjë në jetë dhe falë tij ajo jeton sot pasi që disa herë ka menduar ti jap fund jetës, por B..... ka qenë ai që e ka ndihmuar të largohet nga puna si kameriere dhe po ashtu të larohej nga alkooli. B..... ia ka falur të gjitha veprimet dhe sajimet që i ka bërë në drejtim të tij, ai duke e ditur gjendjen e saj edhe kur shkon në punë gjatë tërë kohës e thërret në telefon, duke u kujdesur për të, ka raste kur nga zëri e ka kuptuar që ajo nuk është mirë, ai ka lënë punën dhe ka shkuar në shtëpi për ta qetësuar. Deklarimet se B..... e ka futur në banjo dhe e ka rrahur e ka pastruar me ujë tepër të ngrohtë asnjë nuk qëndron, edhe njëherë para gjykatës deklaroi se kur është e alkoolizuar ajo nuk e njeh as prindin e saj dhe është në gjendje të sajoi apo të veprojë gjithçka. Para gjykatës deklaroi se B..... është personi që e ka kthyer disa herë në jetë dhe po të mos ishte B..... ajo nuk do të ishte gjallë.

Lëndimet natën kritike i ka marrë duke ecur zhagas nëpër rrugët e qytetit pasi që atë natë ajo ka konsumuar dy litra raki “Badell”, ajo deklaroi para gjykatës se B..... nuk ka pikë faji në lidhje me këtë çështje, për çdo gjë fajtoje është vetë dhe këto veprime i ka kryer nën ndikimin e alkoolit. Tani me ndihmën e B..... ajo ka filluar të trajtohet dhe e ka lënë punën si kameriere, B..... e dërgon me veturë te mjeku dhe ia paguan të gjitha analizat dhe barnat dhe tani janë duke bashkëjetuar.

Përfaqësuesja e zyrës për mbrojtjen e viktimave të krimit -, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë deklaroi: e mbështet deklarin e të dëmtuarës dhe është e vërtetë që edhe në zyrën për mbrojtjen e viktimave të krimit e dëmtuara disa herë ka ardhur nën ndikimin e alkoolit dhe kohëve të fundit është e vërtetë se ka filluar ta marrë veten, mundohet ti largohet alkoolit dhe e njëjta ka sjellur disa dëshmi se është duke u trajtuar për shkak të varësisë nga alkooli.

Mbrojtësi i të pandehurit B.B., Av.Samir Reka, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë dhe gjatë matjes së dënimit kërkon nga gjykata që të ketë

parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese sepse i njëjti ka kompensuar dëmin dhe i ka blerë një telefon të ri të dëmtuarës.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 paragrafi 6, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurit për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të cilat janë në shkresat e lëndës se akuza nuk përmban gabime faktike apo ndonjë shkelje të qartë ligjore, gjykata ka marrë Aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe për të njëjtën veprë penale shpalljen e aktgjykimit e kishte shtyrë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit B.B ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së sepse i pandehuri në kafiterinë “.....”, i ka dëmtuar pasurinë e të dëmtuarës L.S, në atë mënyrë që derisa i pandehuri dhe e dëmtuara ishin duke pirë pije alkoolike, i njëjti i'a merr të dëmtuarës telefonin e tipit “Samsung”, ngjyrë të zezë dhe i'a thyen, me ç'rast i shkakton dëm material në vlerë prej 60 €.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se i pandehuri është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris, ka kompensuar dëmin e shkaktuar, deklaratimet e të dëmtuarës që nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese dhe të pandehurit i shqyrtoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i

tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Kërkesa pasurore-jurudike dhe shpenzimet procedurale

E dëmtuara L.S me vendbanim në rrugën “.....”, Komuna Ferizaj, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet është marrë konform nenit 452 paragrafi 4 i KPPRK-së

II

PJESA E AKTGJYKIMIT REFUZUES

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se pas seancave gjyqësore, administrimit të provave e sidomos duke u bazuar në deklaratimet e të dëmtuarës – dëshmitares L.S, nuk është vërtetuar gjendja faktike sikurse në diapozitivin e parë të akuzës, pasi që edhe gjatë seancave paraprake, por edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor e dëmtuara L.S ka deklaruar se fillimisht ka dhënë një deklaratë në Stacionin Policor më datë 23.04.2024 ku kishte deklaruar se sa i përketë rastit të cilin e ka raportuar në Polici, tani i pandehuri B..... nuk e kishte sulmuar fizikisht mirëpo ajo kishte qenë nën ndikimin e alkoolit, kishte pësuar lëndime trupore fizike të cilat lëndime nuk i kishte marrë nga i pandehuri B....., mirëpo këto lëndime i kishte marrë duke u rrëzuar në tokë dhe në gjendje jo të vetëdijshme që kishte qenë atë kohë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor e dëmtuara ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici dhe jo pranë deklaratës së dhënë në prokurori më datë 06.06.2024, për më tepër deklaroi se tani i pandehuri B..... ka arritur që ta largojë nga varësia e ndikimit të alkoolit dhe se raportet me të njëjtin i kanë shumë të mira. Po ashtu nga vetë deklarimi i të pandehurit sikurse në deklaratën e dhënë në polici, prokurori si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, i njëjti ka deklaruar se asnjëherë nuk ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarës, mirëpo e njëjta gjithnjë kur konsumon pije alkoolike nuk mund të kontrollojë veten ashtu siç ka ndodhur edhe ditën kritike më datë 23.04.2024.

Mbi bazën e këtyre fakteve dhe provave pasi që nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e parë të akuzës heq dorë nga ndjekja penale sa i përketë dispozitivit të parë të akuzës, pra për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4. të KPRK-se.

Gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 364 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të KPPK-së, refuzoi akuzën për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 dhe nën paragrafin 1.4 të KPRK-se, pasi që përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare është tërhequr nga ndjekja penale për këtë veprë penale.

Shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet është marr konform nenit 453 paragrafi 1, të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:165493, datë 25.10.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Lavdije Brahim-Aliu

Gjyqtarja

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.